



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR

Nr. 45 prot.

Peshkopi, më 18.9.2023

NJOFTIM

**“PËR SHPALLJEN TË LIRË TË NJË VENDI PUNE,
NË POZICIONIN “PUNONJËS SHËRBIMI”**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, bazuar në nenet 41, pika 1, 42, 52, pikat 1 dhe 3, 71 dhe 80, pika 1, të ligjit nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996, ligjin nr.9125, datë 29.07.2003, ligjin nr.10053, datë 29.12.2008 si dhe ligjin nr.136/2015, datë 05.12.2015) si dhe urdhrin nr.54, datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e strukturës organike në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, njofton:

-shpalljen e fillimit të procedurës për emërimin e një punonjësi në një vend vakant në pozicionin e punës “Punonjës Shërbimi”, me pagë kategoria e I-rë.

Kandidati duhet të plotësojë të gjitha “kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta”, sipas ligjit nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin e punës “Punonjës Shërbimi”, është si më poshtë:

1. Punonjësi i shërbimit ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) Të zbatojë në mënyrë aktive rregullat dhe rregulloret e prokurorisë, të ruajë sigurinë në mjediset e prokurorisë dhe sigurinë punonjësve të prokurorisë me mbështetjen e punonjësve të policisë së sigurisë;
- b) T’u kërkojë të gjithë anëtarëve të personelit të zbatojnë rregullat për ruajtjen e sigurisë në ambientet e prokurorisë;


- c) Të mos e lërë asnjëherë pa mbikëqyrje pikën komanduese të sigurisë;
- d) Të lejojë punonjësit të hyjnë për nevoja të punës ose shërbimit ose takimet me të punësuarit e institucionit ose personat e jashtëm, vetëm me njoftimin e të punësuarit dhe të shoqërojë qytetarët në destinacionin e tyre;
- e) Në parim, hyrja për në Zyrë, për vizitorët duhet të bëhet nga dyert kryesore tek recepsioni kryesor. Asnjë vizitor nuk duhet të lejohet të hyjë në ndërtesë nga hyrja e pasme ose nga hyrjet e emergjencës.
- f) Të regjistrojë në regjistrin përkatës emrin e personit që bën vizitën, orën e hyrjes dhe emrin e personit/pritësit që ata vizitojnë.
- g) Të mbajnë çdo armë të vizitorëve (nëse kanë) duke bërë regjistrimin përkatës të numrit të saj në regjistër dhe kthimit të saj pas takimit;
- h) Nëse publiku kërkon të bëjë një kallëzim/ankim në lidhje me një çështje, punonjësi i sigurisë nuk duhet të japë mendime ose shpjegime personale por ti drejtojë ata në zyrën përkatëse;
- i) T'u kërkojë të gjithë personave që kanë lënë takim një dokument identifikimi dhe tu kërkojë atyre të nënshkruajnë në një listë dhe në fund të takimit të kthejnë dokumentin e identifikimit dhe të nënshkruajnë;
- j) Të zbatojnë orarin e shërbimit dhe të zbatojnë me saktësi rregullat e shërbimit për marrjen dhe dorëzimin e tij;
- k) Të bashkëpunojnë me personelin policisë së ruajtjes së objekteve për zbatimin e duhur të kërkesave të rregulloreve të brendshme dhe kërkesave specifike të "Rregullores së Policisë së Objekteve" dhe Vendimit Këshillit të Ministrave "Për sigurinë në institucionet shtetërore";
- l) Të jetë i sjellshëm gjatë kontaktit me qytetarët dhe në rastet e konfliktit të informojë kryesekretarin dhe të thërrasin policinë nëse mendon që po shkelet rendi në prokurori dhe ka patur shkelje të rëndë të sigurisë.
- m) Të zbatojë detyra specifike të dhëna nga eprorët për situata të ndryshme si ditët e pushimit, lejet dhe situatën e gatishmërisë;
- n) Në rastin e fatkeqësive natyrore si zjarr, përmbytje dhe dëmtime të rënda nga zjarri, të informojnë shërbimin e mbrojtjes kundër zjarrit;
- o) Të zbatojnë detyra të tjera të lidhura me detyrën që kërkohet nga drejtuesi i prokurorisë dhe kryesekretari;

2. Punonjësi i sigurisë mbikëqyret nga Kryesekretari.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të jenë shtetas shqiptar.



- b) të kenë zotësi juridike për të vepruar.
- b) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c) të kenë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë".
- d) të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të kenë përfunduar arsimin 8 -vjeçar ose 9 -vjeçar, sipas rastit.
- b) Të kenë përvojë punë në sektorët shtetëror apo privat, mbi 5 vjet.
- c) Të ketë aftësi të mira profesionale, organizative dhe etike të lartë komunikimi.
- d) Të jetë i aftë për të kryer në kohë detyrat e ngarkuara.

2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, dokumentet si më poshtë:

a -Jetëshkrim (ose kërkesë)

b-Fotokopje të dëftesës së përfundimit të arsimit të mesëm apo të diplomës së përfundimit të shkollës së lartë të noterizuar.

c -Fotokopje të librezës së punës e noterizuar (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d -Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e -Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f -Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip:

g -Vlerësimin e fundit nga eprori direkt; (nëse ka)

h -Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi; (nëse ka)

i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj; (nëse ka)

j-Vërtetim të gjendjes gjyqësore, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor;

k-Vërtetim që nuk ndiqet penalisht, lëshuar nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor;

l-Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

m-Vërtetim banimi.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentat zyrtarisht, brenda datës 28.09.2023, pranë sekretarisë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, dorazi ose nëpërmjet postës. Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell s'kualifikim të kandidatit.

Ky njoftim hartohet në 5 (pesë) kopje nga të cilat:

- 1(një) kopje vendoset në këndin e njoftimeve të Prokurorisë/Gjykatës,
- 1(një) kopje vendoset në ambientet e brendshme të Prokurorisë/Policisë Gjyqësore,
- 1(një) kopje i dërgohet Bashkisë Dibër, për afishim në këndin e njoftimeve të saj,
- 1(një) kopje i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Dega Dibër,
- 1(një) kopje administrohet në praktikën e emërimit të punonjësit të shërbimit.

DREJTUESI I PROKURORISË

URIM BUÇI

